

VENDIM
Nr. 365, datë 24.4.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NR. 414, DATË 11.7.2007 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LEZHË TË QARKUT TË LEZHËS”, TË NDRYSHUAR, DHE NR. 515, DATË 18.7.2003 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 8 e 8/a, shkronja “b” të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë bashkisë së Lezhës dhe heqjen nga lista e pronave të paluajtshme, bashkëlidhur vendimit nr. 414, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të pjesës së truallit prej 442.8 (katërqind e dyzet e dy pikë tetë) m² të pasurisë 9/49, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8631, të qytetit të Lezhës, e cila përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave.

2. Transferimin në pronësi të bashkisë së Lezhës të mjediseve të Shtëpisë së Ushtarakëve, Lezhë, prona me nr. 981, pjesa e mbetur në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, përjashtuar 3 (tri) mjediset, me sipërfaqe të përgjithshme 42.1 (dyzet e dy pikë një) m² të katit të parë, sipas planimetrisë dhe formularit që i bashkëlidhen këtij vendimi, të cilat do t’i shërbejnë kësaj bashkie për kryerjen e funksioneve administrative e të shërbimeve.

3. Bashkisë së Lezhës i ndalohet t’ia ndryshojë destinacionin pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Mjediset e Shtëpisë së Ushtarakëve, Lezhë, të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të shtohen në listën e pronave të paluajtshme, bashkëlidhur vendimit nr. 414, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Lezhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**1. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)**

MINISTRIA E MBROJTJES
LEZHË

Nr.	A			B			C			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Numri i pronës	Lloji i pronës	Emërtimi i pronës, adresa	Sipërfaqja totale (m ²)	Nga sipërfaqja totale sa ndërtime në m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1				Shtëpia e Ushtarakëve Lezhë	1730 m ²	843 m ²	Për trajnimin e ushtarakëve	MM SHQU Tiranë	Shtëpia e Ushtarakëve Lezhë	-
				Lezhë	887	-				
				Hotel, bar, restorant	843	843				

[illegible]

2

PLANIMETRIA E OBJEKTIT SHTËPIA E USHTARAKËVE LEZHË

